



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1486 Nr. ifaq./Br./str./No. pg. 313
Data/Datum/Date 26 / 1 / 2022
RAHOVEC / ORAHOVAC

Komuna e Rahovecit përmes grupit punues për hartimin e Draft-Rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare, duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe Nenit 6 pika 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Lidhur me konsultimin publik për Draft-Rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare

Ky dokument do të jetë në konsultim publik nga **26.01.2022** deri me datën: **26.02.2022**, ndërsa konsultimi publik me qytetarë do të mbahet me **09.02.2022**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit e cila gjendet në objektin e ri të administratës komunale, me fillim në ora 10:00.

Duke u bazuar në Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/55 i datës: 21.01.2022 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19. Nenit 26 pikave 26.1 dhe 26.2.

26. Përveç nëse përcaktohet ndryshe në këtë Vendim, lejohen grumbullimet në ambiente të mbyllura deri në tridhjetë (30) persona (punëtori, mbledhje, seminare, trajnime apo grumbullime tjera). Përveç atyre nën moshën 12 vjeçare, obligohen pjesëmarrësit që të posedojnë ndonjërin nga dëshmitë e cekura në pikën 26.1 dhe pikën 26.2 në mënyrë që të ju lejohet hyrja në këto ambiente, si dhe organizatori obligohet të siguroj distancën fizike prej një (1) metër në mes të personave dhe kontrollimin e dëshmive përkatëse si:

26.1 Certifikatën e vaksinimit me së paku dy doza ose një dozë të vaksinës Janssen kundër COVID-19;

26.2 Personat me dëshmi mjekësore nga mjeku specialist i fushës përkatëse se kanë kundër indikacione dhe janë të liruar nga vaksinimi, duhet të paraqesin testin RT-PCR negativ për COVID-19, jo më të vjetër se 48 orë.

Komentet dhe sugjerimet e juaja, mund t'i dërgoni deri me datën **26.02.2022** në ora **16:00**, tek zyrtarët: Fidan.Hoti@rks-gov.net; Asllan.Mazreku@rks-gov.net, Blerta.Gashi@rks-gov.net; Skender.Hamza@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Për më shumë detaje, për Draft-Rregulloren për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mund vizitoni vegëzat e mëposhtme:

Uebfaqe zyrtare në rubrikën Konsultime publike, në nënvegëzën dokumente në konsultim publik: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/konsultime-publike-al/dokumente-ne-konsultim-publik/>

Platformë për Konsultime Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20529&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Facebook: <https://www.facebook.com/rahoveckomuna>

Haziz Krasniqi
Zyrtar për Informim

